

Termet e Referencës (TeR)

SPECIALIST PËR SISTEMIN E MENAXHIMIT TË DOKUMENTACIONIT PËR SOFTUERIN PËR MENAXHIMIN E AUDITIMIT

PERIUDHA E ANGAZHIMIT – 4 MUAJ

HISTORIKU

Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra Kombëtare e Auditimit sigurojnë objektivitet dhe pavarësi institucionale duke e ushtruar mandatin e përcaktuar në Kushtetutë dhe ligj, si dhe në përputhje me standardet profesionale të auditimit dhe kodin e brendshme të etikës dhe të sjelljes profesionale.

Zyra Kombëtare e Auditimit, në baza vjetore, kryen një auditim të obligueshëm të Buxhetit së Qeverisë së Kosovës; të gjitha Organizatave Buxhetore që pranojnë buxhet me anë të ligjit vjetor të buxhetit, Ndërmarrjeve Publike, auditime të performancës dhe ka të drejtë në çdo kohë të kryejë auditime tjera përveç atyre të rregullsisë për fondet e dhëna nga buxheti për një institucion ose organizatë; fondet publike për partneritetet publiko-private; huazimet; dhe kreditë dhe detyrimet e garantuara nga entitet e sektorit publik.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm drejtpërdrejtë promovojnë llogaridhënien dhe ofrojnë një bazë solide për të mbajtur llogaridhënës menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin tonë mbi shpenzimin e fondeve publike dhe të luajmë rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe akterëve tjerë në rritjen e llogaridhënies publike.

Duke pasur parasysh këtë, një nga objektivat strategjike të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) është modernizimi dhe digjitalizimi i procesit të auditimit, Sistemi i ri i Menaxhimit të Auditimit (SMA) duhet të zhvillohet dhe të implementohet. Për ta përmbushur këtë duhet të implementohet një platformë e fuqishme për Dokumentim dhe Menaxhim të Procesit Biznesor.

Në lidhje me këtë, Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra Kombëtare e Auditimit ka nisur një iniciativë të zhvillimit të Sistemit të Menaxhimit të Auditimit, sipas të cilit:

1. Organizata përfiton

- Promovimi i konsistencës së dokumentacionit të auditimit, përmes strukturave të standardizuara dhe dokumentimit;
- Aplikimi i praktikave më të mira dhe kërkesave të reja;
- Rritja e efikasitetit të punës së auditorëve (5% - 10% për auditor);
- Rritja e profesionalizmit dhe e morali të ekipeve të auditimit;
- Ruajtje me e lehtë e informacionit dhe reduktim të dosjeve të letrës;
- Identifikimi i dobësive sistematike të klientëve, duke çuar në cilësi më të mirë të rekomandimeve të ZKA-së;
- Zvogëlimi i kostos së ofrimit të informacionit domethënës të menaxhimit (pasi që të dhënat ruhen në një vend qendror);
- Aftësia për t'u lidhur me sistemet tjera (p.sh. vijueshmëria e personelit, regjistrimi i kohës, etj.);

2. Përfitimet për menaxherët

- Menaxhim më i mirë i auditimeve dhe monitorim të progresit (nuk ka nevojë të prisni për një dokument për ta pasur për të parë shkallën e përfundimit të punës në terren) - veçanërisht nëse është mundësuar qasja nga distanca;
- Efikasitet më të mirë përmes përcjelljes me kohë të informacionit;
- Cilësi më të mirë - udhëzimi zhvillohet në çdo auditim;
- Standardizim i procesit – rishikim më i lehtë për të vlerësuar nëse të gjitha auditimet janë dokumentuar në mënyrë të qëndrueshme;
- Lehtësim në gjetjen e provave të auditimit dhe dokumenteve tjera relevante.

3. Përfitimet për ekipet e auditimit

- Standardizimi i procesit të punës;
- Rritja e efikasitetit përmes automatizimit të detyrave (p.sh. krijimi i dosjeve të auditimit, sistematizimi i gjetjeve për vlerësim);
- Referencat e dokumenteve të punës;
- Harmonizimi i qasjes së anëtarëve të ekipit në të njëjtin dosje të auditimit;
- Ndarje më të mirë të njohurive;
- Ruajtja e vazhdimësisë së informacionit nga një vit në tjetrin.

Termet e referencës / produktet

Duke pasur parasysh kontekstin e mësipërm, Zyra Kombëtare e Auditimit është duke kërkuar shërbime këshilluese për Sistemin e Menaxhimit të materialeve audituese përmes platformës elektronike: si

1. Vlerësimin dhe Shqyrtimin e studimit të fizibilitetit për SMA
2. Shqyrtimin e TeR si pjesë e procedurës së tenderit
3. Të ndihmojë procesin e prokurimit deri në kontraktim, dhe
4. Të ndihmojë procesin e mbikëqyrjes së zhvillimit të SMA.

Kualifikimet

- Specialisti/Eksperti që merr detyrën duhet të ketë minimum pesë (5) vjet përvojë në sistemet e menaxhimit të materialeve audituese përmes platformës elektronike.
- Diplomë përkatëse të avancuar universitare ose përvojë pune profesionale ekuivalente të kombinuar me diplomë universitare në një fushë të ngjashme. Niveli i parë universitar në kombinim me përvojën kualifikuese mund të pranohet në vend të nivelit të avancuar universitar.
- Certifikatë (a) në auditim për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë (ISO 9001).
- Përvoja me Analiza Biznesore për identifikimin e proceseve biznesore.

- Përvojë në zhvillimin e diagrameve të rrjedhjes së punëve të proceseve biznesore
- Përvojë të demonstruar në krijimin dhe vlerësimin e proceseve biznesore.
- Përvojë në implementimin e Sistemeve të Menaxhimit të Përmbajtjes së Ndërmarrjes.
- Përvojë në dizajnimin e zgjidhjeve softuerike duke analizuar kërkesat e klientit
- Përvojë në rishikimin e studimeve të fizibilitetit për përgatitjen e implementimit të Sistemeve të Menaxhimit të Përmbajtjes së Ndërmarrjes.
- Përvojë në krijimin e dokumentacionit për Kërkesë për Informacion (RFI), Terma të Referencës (TOR) dhe Kërkesë për Propozim (RFP) për prokurimet e Teknologjisë së Informacionit.
- Përvojë në implementimin e Sistemeve të Menaxhimit të Përmbajtjes së Ndërmarrjes.
- Për shkak të natyrës/ përmbajtjes së dokumentacionit, rrjedhshmëria në gjuhën angleze është e nevojshme. Njohja e gjuhës shqipe dhe serbe do të konsiderohen përparësi.

JU LUTEMI DORËZONI DOKUMENTACIONIN NË VIJIM

Eksperti pritet të dorëzojë një rezymë/CV duke paraqitur angazhimet e mëparshme që plotësojnë kriteret e kualifikimit në mënyrë specifike ato detyra që tregojnë përvojën në zhvillimin dhe zbatimin e Zgjidhjeve për Menaxhimin e Proceseve Biznesore.

Nga eksperti pritet që ta dorëzojë një propozim të çmimit për ta kryer këtë konsulencë. Propozimi teknik dhe financiar duhet të dërgohen bashkë me dokumentacionin e kërkuar me shpallje.